VENDIM
Nr. 125, datë 28.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË DËMSHPËRBLIMIT QË MBULOHET NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, si dhe nenit 11, pika 1, të ligjit nr. 32/2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin Mete

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË DËMSHPËRBLIMIT QË MBULOHET NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT
Miratuar me vendimin e Bordit nr. 125, datë 28.7.2021

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton rregullat, procedurat dhe metodologjinë e llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohen nga kontrata e sigurimit:
a) të përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
b) të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;
c) të përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit lundrues për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
d) të përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni.
2. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit, Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) dhe vlerësuesit e dëmeve në sigurime, si dhe subjektet e tjera të cilat janë të

përfshira në zbatimin e ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe zbatim të tij.

3. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të ligjit nr. 32/2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

4. Tabela nr. 1 "Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar" dhe tabela nr. 2 "Shkalla e humbjes së aftësisë për punë", janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 32/2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", si dhe pikës 2 të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar.

Neni 3
E drejta për dëmshpërblim

Çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për humbjet apo dëmtimet e pësuara, të cilat sipas rastit përbëhen nga:

1. Dëme ndaj personit.

a) dëmi pasuror me pasojë vdekjen, dëmtime ndaj personit të përkohshme dhe të përhershme;

b) dëmi jopasuror:

i. dëm biologjik;

ii. dëm moral;

iii. dëm ekzistencial.

2. Dëme ndaj pronës.

KREU II
PROCEDURA E TRAJTIMIT TË DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK

Neni 4
Detyrimi për informimin e të siguruarit

Shoqëria e sigurimit është e detyruar që së bashku me policën e sigurimit t'i dorëzojë të siguruarit Raportin Evropian të Aksidenteve. Shoqëria e sigurimit mund të pajisë të siguruarin dhe me fletëpalosje, në të cilën të jepen qartë të gjitha veprimet që kryhen dhe dokumentacioni që duhet, në rast se përfshihet në një aksident.

Fletëpalosja duhet të përmbajë informacion mbi:

1. Veprimet e para në momentin e përfshirjes në aksident;

2. Dokumentacionin e nevojshëm që do të shoqërojë kërkesën për dëmshpërblim;

3. Numrat e telefonit të shoqërisë së sigurimit ku mund të drejtohet për asistencë të specializuar.

Neni 5
Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim

1. Pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim:

a) te siguruesi përgjegjës i pronarit të mjetit të transportit, me të cilin është shkaktuar aksidenti;

b) te Byroja Shqiptare e Sigurimit, në rastet e përcaktuara në nenin 41 të ligjit nr. 32/2021;

c) te siguruesi i drejtpërdrejtë në rastet e dëmeve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara/ paidentifikuara, të përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr. 32/2021;

d) te siguruesi i drejtpërdrejtë, në rast aksidenti të dy mjeteve motorike të identifikuara dhe të siguruara me kontratë sigurimi të detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në rast se midis shoqërive të sigurimit është lidhur një marrëveshje.

2. Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim bëhet brenda një periudhe prej 2 viteve nga data e ndodhjes së aksidentit.

3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në rrugë elektronike dhe regjistrohet nga shoqëria e sigurimit/BSHS në një regjistër të veçantë.

4. Shoqëria e sigurimit/BSHS është e detyruar:

a) të pajisë palën e dëmtuar me numrin e regjistrimit të kërkesës për dëmshpërblim. Ky numër shërben si vërtetim që pala e dëmtuar ka paraqitur një kërkesë të tillë dhe është regjistruar;

b) të pajisë palën e dëmtuar me një formular që përmban udhëzime, instruksione dhe listën e dokumenteve të nevojshme për plotësimin e dosjes së dëmit, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me trajtimin e dosjes së dëmit;

c) të raportojë në regjistrin elektronik të dëmeve sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren përkatëse, brenda 1 dite pune nga momenti i hapjes së dosjes së dëmit.

5. Kërkesa për dëmshpërblim mund të jetë dhe formular standard i shoqërisë së sigurimit, që i jepet palës së dëmtuar për ta plotësuar në rast dëmi. Shoqëria e sigurimit publikon formatin e kërkesës edhe në faqen e saj zyrtare të internetit.

6. Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit/BSHS i drejtohet kërkuesit me shkrim brenda 8 ditëve kalendarike pas pranimit të kërkesës ku liston të gjitha kërkesat për plotësimin e dokumentacionit.

7. Pala e dëmtuar nuk është e detyruar të përsërisë kërkesën për dëmshpërblim, në rast se identifikohet shoqëria e sigurimit të mjetit shkaktar të aksidentit. Në këtë rast shoqëria e sigurimit/BSHS që disponon kërkesën për dëmshpërblim e dërgon atë te shoqëria e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit brenda 3 ditëve kalendarike nga data e identifikimit të shoqërisë së sigurimit përgjegjëse. Kjo e fundit njofton palën e dëmtuar për marrjen e kërkesës për dëmshpërblim.

Neni 6

Hapja e praktikës së dëmit

1. Shoqëria e sigurimit/BSHS pasi bën regjistrimin e kërkesës për dëmshpërblim nga pala e dëmtuar, hap praktikën e dëmit.

2. Praktika e dëmit hapet e veçantë për çdo person, mjet transporti apo pronë të dëmtuar në një aksident.

3. Shoqëria e sigurimit/BSHS është e detyruar të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim sipas ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

4. Përbërja e praktikës së dëmit, në momentin e hapjes, përfshin:

a) elementet e identifikimit të praktikës (kodi unik, numri i dosjes, kodi i degës ku hapet praktika, data dhe vendi i aksidentit);

b) elementet e identifikimit të palës së dëmtuar (emër, mbiemër, adresa, nr. tel, adresa e postës elektronike/të dhëna për mjetin e dëmtuar / të dhëna identifikuese të pronës së dëmtuar, të dhëna për policën e sigurimit);

c) elementet e identifikimit të shkaktarit të dëmit (ID, emër, mbiemër, adresa, nr. tel, elementet e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj).

d) elementet e identifikimit të pronarit të mjetit shkaktar të dëmit (ID, emër, mbiemër, adresa, nr. tel, elementet e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj) në rast se shkaktari i dëmit është i ndryshëm nga pronari i mjetit të transportit.

5. Shoqëritë e sigurimit/BSHS gjatë administrimit të dhënave personale të subjekteve zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 7

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit sipas vlerësimit të përllogaritur nga vlerësuesi i licencuar nga Autoriteti apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim:

a) për dëme ndaj personit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim;

b) për dëme ndaj pronës me vlerë mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim.

2. Shoqëria e sigurimit kryen pagesën e dëmshpërblimit për dëme ndaj pronës me vlerë deri në 100,000 (njëqind mijë) lekë, brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

3. Për qëllim të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, përllogaritja e afateve të trajtimit fillon nga data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues.

4. Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim shoqëria duhet të njoftojë palën e dëmtuar:

a) në rast pranimi të kërkesës, për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj;

b) në rast refuzimi të kërkesës, shkaqet ligjore me shkrim, që çojnë në këtë refuzim.

5. Shoqëria e sigurimit duhet të dokumentojë njoftimin për masën e dëmshpërblimit duke bashkëngjitur aktin e vlerësimit të dëmit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim i cili do të bëhet për çdo rast me shkrim, duke e dërguar në adresën e palës së dëmtuar nëpërmjet organeve postare si letër rekomande ose në adresën elektronike apo me mesazh në numrin e telefonit në rastet kur këto jepen nga kërkuesi i dëmshpërblimit në formularin e kërkesës për dëmshpërblim. Me kërkesë të palës së dëmtuar/përfituesi, shoqëria e sigurimit është e detyruar të njoftojë me shkrim masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim.

6. Pala e dëmtuar, me marrjen e njoftimit sipas pikave 4 dhe 5, të këtij neni, ka të drejtën e ankimimit pranë shoqërisë së sigurimit. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i përgjigjet ankimit të palës së dëmtuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit.

7. Siguruesi përgjegjës, gjithashtu, ka të drejtë të publikojë në faqen e internetit ose nëpërmjet programeve analoge listën e përfituesve të dëmshpërblimit dhe t'i ftojë ata të paraqiten pranë zyrave përkatëse për t'u njohur me vlerën e përllogaritur, për ta tërhequr atë nëse e pranojnë dhe për të përmbyllur praktikën përkatëse të dëmshpërblimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Shoqëria e sigurimit duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit në llogarinë bankare personale të dëmtuarit ose përfituesit.

9. Shoqëria e sigurimit për rastet e pikës 1 të këtij neni kryen pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas përfundimit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit.

10. Në rast të mosrespektimit të afatit të përcaktuar në këtë nen, palës së dëmtuar i lind e drejta e përfitimit të interesit të pagueshëm për çdo ditë kalendarike vonesë në shlyerjen e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit.

Neni 8
Refuzimi i dëmshpërblimit

1. Në rastin e refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, shoqëria e sigurimit është e detyruar të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore që çojnë në këtë refuzim.

2. Pavarësisht se kërkesa për dëmshpërblim është refuzuar, shoqëria e sigurimit fillon procedurën e trajtimit të dëmit, nëse pala e dëmtuar paraqet prova të reja të kërkuara nga shoqëria e sigurimit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit sipas pikës 2, të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

KREU III
RREGULLAT DHE METODOLOGJIA PËR DËMIN PASUROR NDAJ PERSONIT

Neni 9
Dokumentacioni i praktikës së dëmit

Praktika e dëmit ndaj personit përmban dokumente të përgjithshme, dokumente specifike dhe dokumente të tjera.

Neni 10
Dokumente të përgjithshme

Dokumentet e përgjithshme për dëmet ndaj personit janë si më poshtë:

1. Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit.

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftimit të kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu, të shpjegojë rrethanat e ngjarjes.

2. Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit.

Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me policën e sigurimit të mjetit shkaktar të demit.

3. Llogaria bankare e përfituesit/dëmtuarit në një bankë të nivelit të dytë për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit/BSHS.

4. Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga policia rrugore për ngjarjen dhe/ose vendim nga organet gjyqësore për përcaktimin e shkaktarit të aksidentit dhe/ose dokumentacion i procedimit penal për përcaktimin e shkaktarit të aksidentit.

Neni 11
Dokumente specifike

Dokumentet specifike për dëmet ndaj personit janë si më poshtë:

1. Certifikata familjare, certifikata e trungut familjar në momentin e aksidentit dhe letërnjoftim ID për të dëmtuarin.

Certifikata familjare e personit të dëmtuar, certifikata e trungut familjar në rastin e paaftësisë së përhershme (pjesore ose totale) dhe të përkohshme, duhet të jetë sipas formatit zyrtar, e nënshkruar dhe e vulosur nga organi kompetent.

2. Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tri vitet e fundit.

Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tri vitet e fundit (duke filluar nga data e aksidentit), i detajuar për çdo muaj i lëshuar nga organet kompetente përkatëse.

Neni 12

Dokumente të tjera specifike

1. Për dëme ndaj personit me pasojë vdekje, përveç atyre të parashikuara në nenet 10 dhe 11, do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

a) skeda e vdekjes;

b) certifikata e vdekjes;

c) akti i përcaktimit të trashëgimtareve të të ndjerit.

2. Për dëme ndaj personit me paaftësi të përhershme, përveç atyre të parashikuara në nenet 10 dhe 11, do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

a) raporti i paaftësisë së përhershme për punë i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën nr. 2 "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë" bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) radiografi/ skaner/ rezonancë magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente.

3. Për dëme ndaj personit me paaftësi të përkohshme, përveç atyre të parashikuara nenin 10, do të përfshihet edhe raporti i paaftësisë së përkohshme, i cili do të përcaktohet nga organi kompetent shëndetësor si dhe dokumenti i të ardhurave të përfituara për periudhën e paaftësisë së përkohshme.

Neni 13

Dokumente të tjera të praktikës së dëmit

1. Përveç sa është parashikuar në nenet 10, 11 dhe 12, të kësaj rregulloreje, çdo praktikë dëmi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) aktvlerësimi i demit;

Aktvlerësimi i dëmit kryhet vetëm nga vlerësuesi i dëmeve i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në aktvlerësim do të përfshihen të gjitha elementet e domosdoshme që kërkojnë shpenzime.

b) relacion përmbledhës, ku pasqyrohet gjithë procesi, nga hapja e dosjes deri në përfundim. Në relacion duhet të përfshihet opinioni për vërtetësinë e rastit të sigurimit;

c) deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar;

d) dokumenti që vërteton njoftimin e palës së dëmtuar për masën dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, sipas pikës 5, të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

2. Përveç sa është parashikuar në këtë nen, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 14

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë

1. Bazuar në pikën 3, germa "a", të nenit 25, të ligjit nr. 32/2021, në rastin e dëmeve me pasojë paaftësi të përhershme për punë, kur vërtetohet humbja e të ardhurave, përfitimi llogaritet si produkt i të ardhurave vjetore neto me koeficientin e shumës së kapitalizuar, moshës së daljes në pension dhe humbjes së aftësisë për punë.

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme në punë bëhet sipas kësaj formule:

$$\mathbf{D = T_{ap} \cdot K_{Shk} \cdot K_{mdp} \cdot K_{hap}}$$

ku:

D – dëmshpërblimi

$\mathbf{T_{ap}}$ – të ardhurat personale vjetore

$\mathbf{K_{Shk}}$ – koeficienti i shumës së kapitalizuar;

$\mathbf{K_{mdp}}$ – koeficienti i moshës së daljes në pension;

$\mathbf{K_{hap}}$ – koeficienti i humbjes së aftësisë për punë.

Vlerës së dëmshpërblimit të llogaritur sipas pikës 1, të këtij neni, do t'i shtohen edhe shpenzimet spitalore e farmaceutike të kryera nga i dëmtuari brenda periudhës së paaftësisë dhe të vërtetuar me dokumente të rregullta.

2. Do të konsiderohen të ardhura personale vjetore **(Tap)**:

a) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë në marrëdhënie pune në momentin e aksidentit, do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit të konfirmuara nga organet kompetente;

b) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë i vetëpunësuar do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit të deklaruara dhe të konfirmuara nga organet përkatëse;

c) në rast se i/e dëmtuari/a nuk ka qenë në marrëdhënie pune në kohën e ngjarjes do të referohet në pagën minimale zyrtare bruto të vendbanimit në kohën e ngjarjes;

d) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë i punësuar jashtë vendit do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit, e konfirmuar nga organet kompetente;

e) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë në pension, shuma e pensionit që ka marrë vitin e fundit e shprehur në bazë vjetore;

f) fitimi i shoqërisë (i shpërndarë ose jo), nuk llogaritet në të ardhurat personale të aksionerit/ortakut;

g) për periudhat në të cilën i dëmtuari nuk ka qenë në marrëdhënie pune, në llogaritjen e të ardhurave për 3 vitet sipas pikave "a", "b", "d" të mësipërme, do të merret në konsideratë paga minimale zyrtare bruto e periudhës;

h) për të dëmtuarit e mitur (deri në 16 vjeç) dhe të papunë, si e ardhur vjetore do të merret paga minimale zyrtare bruto e vendbanimit në kohën e ngjarjes.

3. Koeficienti i shumës së kapitalizuar (**Kshk**) paraqitet në tabelën nr. 1 "Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar", bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

4. Koeficienti i moshës së daljes në pension **(Kmdp)**, llogaritet:

a) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë në pension, koeficienti i moshës së daljes në pension do të merret 0.80;

b) në rast se i/e dëmtuari/a nuk ka qenë në pension, koeficienti i moshës së daljes në pension do të merret 0.90.

5. Koeficienti i humbjes së aftësisë për punë **Khap** jepet nga KMCAP-i (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë) ose komisioni mjekësor i ngritur nga shoqëria e sigurimit, duke u mbështetur në tabelën nr. 2 (shkalla e humbjes së aftësisë për punë), bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Komisioni përbëhet nga të paktën 3 mjekë specialistë të fushave të ndryshme.

6. Për të dëmtuarit nën 12 vjeç, për efekt llogaritjeje merret koeficienti i llogaritjes së shumës së kapitalizuar që i korrespondon moshës 12 vjeç.

7. Për të dëmtuarit mbi 80 vjeç, për efekt llogaritjeje merret koeficienti i llogaritjes së shumës së kapitalizuar që i korrespondon moshës 80 vjeç.

Neni 15

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë vdekje

1. Bazuar në pikën 3, germa "b", të nenit 25, të ligjit 32/2021, në rastet e dëmeve me pasojë vdekje, dëmi pasuror do të llogaritet si në rastin e paaftësisë së plotë të përhershme me ndryshimin që nga të ardhurat sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje, të zbriten të ardhurat për nevojat e vetë personit, të cilat varen nga numri i personave në familje.

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë vdekje bëhet sipas kësaj formule:

$$\mathbf{D = (T_{ap} - K_{avnp} \cdot T_{ap})K_{Shk} \cdot K_{mdp}}$$

ku:

$\mathbf{D}$ – dëmshpërblimi

$\mathbf{T_{ap}}$– të ardhurat personale vjetore

$\mathbf{K_{avnp}}$ – koeficienti i të ardhurave për vetë nevojat e personit

$\mathbf{K_{Shk}}$ – koeficienti i shumës së kapitalizuar

$\mathbf{K_{mdp}}$ – koeficienti i moshës së daljes në pension

2. Të ardhurat personale, koeficienti i shumës së kapitalizuar dhe koeficienti i moshës së daljes në pension janë të njëjta me përcaktimet e dhëna në nenin 14, të kësaj rregulloreje.

3. Përqindja e të ardhurave për nevojat e vetë personit ($\mathbf{K_{avnp}}$) do të jetë si më poshtë:

a) kur i ndjeri ka pasur në familje tre ose më shumë se tre persona (pa të ndjerin) pjesa që do të zbritet është 30% e të ardhurave;

b) kur i ndjeri ka pasur në familje dy persona (pa të ndjerin) pjesa që do të zbritet është 40% e të ardhurave;

c) kur i ndjeri ka pasur në familje një person (pa të ndjerin) pjesa që do të zbritet është 50% e të ardhurave.

4. Kur i ndjeri është nën moshën 16 vjeç, trashëgimtarët e tij do të dëmshpërblehen në shumën fikse prej 2,500,000 lekë.

5. Nëse trashëgimtarët e të ndjerit janë të mitur, dëmshpërblimi do të depozitohet në emër të tyre në një bankë të nivelit të dytë, e cila operon në Republikën e Shqipërisë.

6. Në vlerën e dëmshpërblimit me pasojë vdekje do të shtohen edhe shpenzimet e varrimit në shumën fikse prej 300,000 lekë.

7. Nëse i ndjeri ka qenë i vetëm në familje do të paguhen vetëm shpenzimet e varrimit. Këto shpenzime i paguhen subjektit që ka kryer shërbimet funerale ose shtetit.

Neni 16

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përkohshme në punë

1. Bazuar në pikën 3, germa "c", të nenit 25, të ligjit nr. 32/2021, në rastet e dëmeve me pasojë paaftësinë e përkohshme, humbja financiare përbën pjesën e papaguar të pagës për kohën e paaftësisë.

2. Humbja e përkohshme e aftësisë për punë përcaktohet nga organi kompetent shëndetësor, për një periudhë deri në 6 muaj.

3. Kur i dëmtuari është i punësuar në sektorin privat apo publik, dëmshpërblimi mujor llogaritet si diferencë midis pagës të muajit të fundit para aksidentit dhe pagës që përfitohet nga raportet mjekësore.

4. Kur i dëmtuari është i papunë, dëmshpërblimi i përfituar sipas pikës 2 të këtij neni, llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{D} = \frac{\mathbf{P_{mz}} \cdot \mathbf{P_{rd}}}{\mathbf{d}}$$

ku:

D – dëmshpërblimi

$\mathbf{P_{mz}}$ – paga minimale zyrtare

$\mathbf{P_{rd}}$ – periudha e paaftësisë së përkohshme në ditë pune

d – 22 ditë

5. Përveç dëmshpërblimit të shprehur në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni, të dëmtuarit do t'i paguhen edhe shpenzimet spitalore e farmaceutike të kryera nga ai brenda periudhës së paaftësisë së përkohshme dhe të vërtetuara me dokumente të rregullta përkatëse.

6. Kur i dëmtuari është i mitur (nën 16 vjeç), ose pensionist si dëmshpërblim do të konsiderohen pagesat e shpenzimeve spitalore e farmaceutike të kryera nga ai.

KREU IV
RREGULLAT DHE METODOLOGJIA PËR DËMIN JOPASUROR NDAJ PERSONIT

Neni 17
Dëmi jopasuror

1. Çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 25, të ligjit nr. 32/2021, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëme jopasurore.

2. Dëmi jopasuror është dëmi biologjik, ekzistencial dhe moral i pësuar nga cenimi i të drejtave dhe i interesave jopasurore, që lidhet me dhimbjet fizike, paaftësinë për punë, frikën, shëmtimin, dhimbjet dhe vuajtjet shpirtërore të personit të dëmtuar dhe familjarëve të tij në rastin e vdekjes së personit ose përkeqësimit të shëndetit të tij.

3. Dëmi jopasuror përbëhet nga:

a) dëm biologjik;

b) dëm moral;

c) dëm ekzistencial.

Neni 18
Dëmi biologjik

1. Dëmi biologjik përbën në thelb cenimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut dhe që ka një ndikim negativ në aktivitetin jetësor të përditshëm, në aspektin dinamik dhe ndërpersonal të jetës së palës së dëmtuar, pavarësisht kthimit të mundshëm të kapacitetit të tij për të siguruar të ardhura.

2. Dëmi biologjik llogaritet për çdo person të dëmtuar sipas moshës dhe shkallës së paaftësisë së pësuar. Vlera e dëmit biologjik për çdo person të dëmtuar do të jetë jo më shumë se 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë për çdo 10% të shkallës së paaftësisë së përhershme, të pjesshme ose të plotë.

3. Dëmi biologjik llogaritet, si më poshtë:

Deri në moshën 20 vjeç

a) deri në 30% 100,000 lekë

	mbi 30%	110,000 lekë
b)	Prej moshës 21 vjeç deri në 30 vjeç deri në 30%	85,000 lekë
	mbi 30%	100,000 lekë
c)	Prej moshës 31 vjeç deri në 50 vjeç deri në 30%	50,000 lekë
	mbi 30%	85,000 lekë
ç)	Prej moshës 51 vjeç deri në 70 vjeç deri në 30%	40,000 lekë
	mbi 30%	65,000 lekë
d)	Mbi moshën 70 vjeç deri në 30%	35,000 lekë
	mbi 30%	55,000 lekë

Neni 19
Dëmi moral

1. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore individuale dhe e familjarëve të të dëmtuarit.

2. *Përllogaritja e dëmit moral me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:*

a) Vlera e dëmit moral për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{4}$ *e dëmit biologjik;*

- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{4}{5}$ *e dëmit biologjik;*

- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;

- mbi 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{5}{4}$ *e dëmit biologjik;*

- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{2}$ *e dëmit biologjik.*

b) Vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të dëmtuarit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, do të jetë jo më shumë se 1/5 e përfitimit të dëmtuarit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë sipas pikës 2, germa a), të këtij neni;

c) Vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit do të jetë jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë.

3. Përllogaritja e dëmit moral me pasojë vdekjen, bëhet si më poshtë:

a) vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, për vdekjen e të afërmit do të jetë jo më shumë se 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë;

b) vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, vëlla/motër vlera e përfitimit është jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë.

4. Dëmi moral me pasojë paaftësinë e përkohshme është jo më shumë se 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo muaj paaftësi të përkohshme.

Neni 20
Dëmi ekzistencial

1. Dëmi ekzistencial është cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut, duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri ose të familjarëve të tij në botën e jashtme, duke

tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, si në cilësinë e jetës, ashtu dhe në marrëdhëniet personale dhe familjare.

2. *Përllogaritja e dëmit ekzistencial, me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:*

a) Vlera e dëmit ekzistencial për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë, si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{4}$ *e dëmit biologjik;*

- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{4}{5}$ *e dëmit biologjik;*

- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;

- nga 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{5}{4}$ *e dëmit biologjik;*

- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{2}$ *e dëmit biologjik.*

b) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të dëmtuarit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, do të jetë jo më shumë se 1/5 e përfitimit të dëmtuarit me pasojë paaftësinë e përhershme sipas pikës 2, germa "a", të këtij neni;

c) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë.

3. Përllogaritja e dëmit ekzistencial me pasojë vdekjen, bëhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, për vdekjen e të afërmit do të jetë jo më shumë se 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë;

b) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, vëlla/motër vlera e përfitimit është jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë.

4. Dëmi ekzistencial me pasojë paaftësinë e përkohshme është jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo muaj paaftësi të përkohshme.

Neni 21

Kufiri i mbulimit të përgjegjësive

1. Kufiri i mbulimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta pavarësisht nga përllogaritjet e bëra sipas kësaj rregulloreje nuk duhet të tejkalojnë në asnjë rast limitet e përcaktuara në nenin 25, pika 5, të ligjit nr. 32/2021.

2. Në rast se ka disa palë të dëmtuara nga një ngjarje sigurimi dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin ndaj personit, si dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin ndaj pronës tejkalon shumat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shuma e dëmshpërblimit dhe të drejtat e palëve të dëmtuara ndaj shoqërisë së sigurimit zvogëlohen në mënyrë përpjesëtimore për secilën figurë të dëmit ndërmjet të gjithë të dëmtuarve deri në përfundim të gjithë shumës së siguruar sipas kontratës së sigurimit.

KREU V

TRAJTIMI I TË DËMTUARVE ME SHËRBIME MJEKËSORE JASHTË VENDIT

Neni 22

Procedurat e kurimit të të dëmtuarve jashtë vendit

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje do të konsiderohen të dëmtuar që kurohen jashtë vendit të gjithë ata të dëmtuar që përfitojnë nga ligji nr. 32/2021 dhe që rekomandohen për kurim jashtë vendit nga komisioni përkatës pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Komisioni arsyeton mbi mundësinë e kurimit të të dëmtuarit brenda, apo jashtë vendit dhe shprehet për rastet kur është i nevojshëm kurimi jashtë vendit, duke rekomanduar edhe klinikën që do të kurohet.

3. Për çdo të dëmtuar, shoqëria e sigurimit duhet të bjerë dakord rast pas rasti me klinikën që merr përsipër kurimin, për çmimin për çdo ditë qëndrimi të të dëmtuarit dhe shoqëruesin e tij, llojin e ndërhyrjeve, numrin e tyre, çmimin për çdo ndërhyrje dhe afatin e kurimit.

4. Klinika kuruese do të paguhet nga shoqëria që ka siguruar mjetin shkaktar të dëmit, sipas faturave të paraqitura. Këto shpenzime konsiderohen dëmshpërblim për të dëmtuarin.

5. Nëse i dëmtuari edhe pas kurimit jashtë vendit rezulton me paaftësi të përhershme për punë, për dëmshpërblim të mëtejshëm të tij do të veprohet sipas rregullave mbi "Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë (përkeqësim shëndeti)".

6. Kur të dëmtuarit kurohen jashtë vendit pa miratimin me shkrim sipas procedurave të përmendura më lart, dëmshpërblimi do të llogaritet sipas nenit 14 "Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë (përkeqësim shëndeti)", si dhe nenit 17 e vijues të kësaj rregulloreje.

7. Përjashtim konsiderohen rastet, vetëm kur personi i dëmtuar për shkaqe shëndetësore urgjente që rrezikojnë jetën e tij, duhet të kurohet jashtë vendit.

KREU VI
RREGULLAT DHE METODOLOGJIA PËR DËMIN NDAJ PRONËS

Neni 23
Dokumentacioni i praktikës së dëmit

Praktika e dëmit ndaj pronës përmban dokumente të përgjithshme, dokumente specifike dhe dokumente të tjera.

Neni 24
Dokumente të përgjithshme

Dokumentet e përgjithshme për dëmet ndaj pronës janë si më poshtë:

1. Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit.

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftim kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes.

2. Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit.

Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me kopje të policës së sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

3. Llogaria bankare dhe emri i bankës për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit/BSHS.

4. Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen ose Raporti Evropian i Aksidenteve / Vendim nga organet gjyqësore për përcaktimin e shkaktarit të aksidentit.

Neni 25
Dokumente specifike

Dokumentet specifike për dëmet ndaj pronës janë si më poshtë:

1. Dokumenti i pronësisë së mjetit ose objektit të dëmtuar.

2. Aktekspertimi i dëmit.

Aktekspertimi i dëmit duhet të hartohet nga specialisti i shoqërisë së sigurimit në vendndodhjen e objektit të dëmtuar, në prani dhe të palës së dëmtuar ose të përfaqësuesit të tij.

Akti i ekspertimit duhet të hartohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të aksidentit nga pala e dëmtuar.

Aktekspertimi i dëmit duhet të jetë i nënshkruar nga të dyja palët.

3. Foto të mjetit shkaktar të dëmit.

Fotoja e mjetit shkaktar të dëmit, duhet të paraqesë në mënyrë të qartë targën dhe pjesët e dëmtuara si rrjedhojë e ngjarjes.

4. Foto të mjetit ose objektit të dëmtuar.

Foto e mjetit ose objektit të dëmtuar duhet të bëhet nga shoqëria e sigurimit që hap dosjen e dëmit gjatë procesit të ekspertimit. Praktika e dëmit duhet të përmbajë jo më pak se 3 (tri) foto të mjetit/objektit të dëmtuar në pozicione të ndryshme. Në foto duhet të paraqiten qartë pjesët e dëmtuara, si dhe në një nga fotot të pasqyrohet qartë pamja e përgjithshme e mjetit të dëmtuar së bashku me targën e tij.

Neni 26

Dokumente të tjera të praktikës së dëmit

Përveç sa është parashikuar në nenet 24 dhe 25 të kësaj rregulloreje, çdo dosje dëmi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:

1. Aktvlerësimi i demit.

Aktvlerësimi i dëmit kryhet vetëm nga vlerësuesi i dëmeve i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në aktvlerësim do të përfshihen të gjitha elementet e domosdoshme që kërkojnë shpenzime.

2. Relacion përmbledhës, ku pasqyrohet gjithë procesi, nga hapja e dosjes deri në përfundim. Në relacion duhet të përfshihet opinioni për vërtetësinë e rastit të sigurimit.

3. Deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

4. Dokumenti siç përcaktohet në nenin 7, pika 4, që vërteton marrjen nga i dëmtuari të njoftimit për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim.

Përveç sa është parashikuar në këtë nen, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 27

Dokumentet e praktikës së demit që trajtohen me Raportin Evropian të Aksidenteve

Dokumentet për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim për dëme me vlerë deri 30 mijë lekë, për të cilat palët kanë nënshkruar Raportin Evropian të Aksidentit përfshijnë:

1. Formularin e Raportit Evropian të Aksidenteve.

Raporti Evropian i Aksidenteve (sipas formatit të miratuar nga Autoriteti), duhet të paraqitet nga pala e dëmtuar. Formulari duhet të plotësohet me korrektësi nga pjesëmarrësit në aksident dhe të jetë i nënshkruar nga këta pjesëmarrës. Ky formular konsiderohet kërkesë për dëmshpërblim.

2. Fotografi në momentin e aksidentit të mjeteve të dëmtuara.

Fotografi të mjeteve të dëmtuara duhet të bëhen para lëvizjes së mjeteve nga një distancë e afërt dhe e largët (dëmtimin e mjeteve, gjurmët e frenimit, mbeturinat e rëna në rrugë) dhe gjurmët e rëndësishme si pozicioni i mjeteve, i rrotave etj. Fotografitë duhet të jenë në mënyrë të qartë duke pasqyruar pjesët e dëmtuara dhe targën e mjeteve.

Mungesa e fotografive kërkon ekspertizën e mjetit të dëmtuar nga ana e shoqërisë së sigurimit përgjegjëse.

3. Dokumentet e identifikimit të palëve të përfshira në aksident (ID);

4. Dokumentet e mjeteve dhe drejtuesve të tyre (leje qarkullimi, leje drejtimi, kopje e policave të sigurimit).

KREU VII
METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES SË DËMIT NDAJ PRONËS

Neni 28
Kategorizimi i mjeteve

Mjetet motorike në varësi të vitit të prodhimit ose vënies në qarkullim kategorizohen si më poshtë:

Grupi i parë: përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në interval kohor ushtrimor 4 (katër) vjet përpara ditës së dëmit;

Grupi i dytë: përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në interval kohor ushtrimor 6 (gjashtë) vjet përpara atij të grupit të parë;

Grupi i tretë: përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në intervalin kohor përpara grupit të dytë.

Neni 29
Dokumentacioni që përcakton grupin e mjetit

1. Dokumentacioni që përcakton grupin e mjetit është:

a) leje e qarkullimit të mjetit;

b) certifikata e pronësisë së mjetit.

2. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni duhet të paraqitet: Origjinal ose kopje e noterizuar e tij.

3. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1, përcaktimi i grupit do të bëhet nëpërmjet botimeve të fundit të katalogëve ndërkombëtare të njohura.

Neni 30
Vlerësimi i dëmit ndaj pronës

1. Mënyra e llogaritjes së vlerës së dëmshpërblimit do të zgjidhet në funksion të amortizimit të mjetit motorik, vlerës aktuale dhe gjendjes teknike të tij, mundësisë për sigurimin e pjesëve të këmbimit, nivelit të kërkesave për riparim etj.

2. Pas kryerjes së ekspertimit të dëmit dhe vlerësimit të mjetit para ngjarjes, kryhet vlerësimi i dëmit duke e pasqyruar atë në aktvlerësim dëmi. Aktvlerësimi detyrimisht përmban:

Në pjesën e parë:

Emrin e përfituesit të dëmit.

Emrin e shkaktarit të dëmit në momentin e aksidentit. Policën e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

Në pjesën e dytë:

Të gjitha elementet që pasqyrohen në këtë pjesë plotësohen gjatë ekspertimit fizik të mjetit të dëmtuar me qëllim që të bëhet më pas krahasimi më dokumentacionin përkatës që i korrespondon mjetit.

Në pjesën e tretë:

Përshkruhen dëmtimet dhe numri i pjesëve të dëmtuara dhe shënohet emërtimi i pjesës, gjendja e automjetit dhe mënyra e riparimit, në varësi të shkallës së dëmtimit duke i ndarë në:

a) pjesë për ndërrim;

b) pjesë për riparim (L, M, V);

c) pjesë për kontroll dhe adoptim.

3. Si në rastin e dëmtimit pjesor apo shkatërrimit total të pronës, dëmshpërblimi ndaj pronës në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë vlerën aktuale të pronës së dëmtuar duke u bazuar në parimin e zëvendësimit.

4. Në vlerën e dëmshpërblimit duhet të përfshihen dhe shpenzimet për transportin e mjetit motorik, shpenzime ruajtjeje dhe shpenzime gjyqësore apo noteriale.

5. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i ofrojë palës së dëmtuar dëmshpërblim në vlerë monetare ose riparim të mjetit në servis.

6. Elementet e detajuara të vlerësimit të dëmit ndaj mjetit përcaktohen në manualet e dëmeve të shoqërive. Manualet e shoqërive dhe çdo ndryshim i kryer në to duhet të depozitohen në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 31

Ndërrimi i pjesëve të dëmtuara

1. Për dëmtime, për të cilat nuk ekzistojnë mundësitë teknike për një riparim cilësor dhe ekonomik, do të kryhet ndërrimi i pjesëve ose i strukturës së mjetit motorik.

2. Nëse mjeti nuk ka dëmtime të mëdha, ndërrohen:

a) pjesët e dëmtuara të cilat ndikojnë në sigurinë e automjetit;

b) pjesët e dëmtuara të cilat me riparimin e tyre, nuk mund të kthehen në gjendjen e mëparshme nga ana estetike;

c) struktura të pjesshme, të cilat duhen të jenë në harmoni me udhëzimet e prodhuesit.

3. Nëse, si rezultat i aksidentit, ka thyerje të xhamit të mjetit, duhet të përcaktohet saktësisht lloji i xhamit, cilësia e tij, mënyra e ngjitjes si dhe cilësi të tjera të cilat kanë rëndësi në vlerësimin real të dëmit.

4. Nëse për shkak të dëmtimeve të mëdha, është e domosdoshme ndërrimi i pjesëve të cilat (edhe të ngjashme) nuk gjenden në treg, me pëlqimin e palës së dëmtuar mund të bëhet riparimi i pjesës së dëmtuar, duke kërkuar dhe një kohë shtesë për këtë riparim.

5. Automjeti do të konsiderohet jashtë përdorimi kur kostoja e riparimit është mbi 80% e vlerës së mjetit ose kur riparimi i mjetit është teknikisht i pamundur. Në këto raste shoqëria e sigurimit do të kompensojë palën e dëmtuar në vlerën e plotë të mjetit, përveç rasteve kur shoqëria e sigurimit bie dakord me palën e dëmtuar për pjesën e mbetur të mjetit.

Neni 32

Pjesët për riparim

1. Pjesët e dëmtuara të mjetit riparohen, me kusht që të ruhet siguria e mjetit;

2. Shkalla e dëmtimit të mjetit ndahet në:

a) dëmtime të vogla (V), konsiderohen dëmtime në pjesët e jashtme pa deformime të mëdha, pjesët e dëmtuara mund të riparohen lehtë me pak orë punë dhe materiale, si dhe gjenden në pozicione të përshtatshme për t'u riparuar;

b) dëmtime të mesme (M), konsiderohen dëmtime të cilat janë të dukshme dhe të theksuara dhe gjenden në pozicione të papërshtatshme për t'u riparuar;

c) dëmtime të larta (L) konsiderohen dëmtime me deformime të mëdha dhe gjenden në vende jashtëzakonisht të papërshtatshme për riparim.

Neni 33

Pjesët për kontroll dhe adoptim

Nëse dëmtimi i mjetit, si pasojë e aksidentit ndikon në rregullimin gjeometrik të pjesëve të dëmtuara ose ndërlidhëse të mjetit është i nevojshëm kontrolli konkret i tij dhe, veçanërisht:

1. Gjeometria e rrotave;
2. Gjeometria e pikave matëse të karrocerisë, shasisë etj.;
3. Sistemi i drejtimit, rezervuari i karburantit etj.

Neni 34

Riparimi i mjetit në servis

1. Riparimi në servis aplikohet në rastet kur mjeti i dëmtuar autorizohet, me pëlqimin e palës së dëmtuar, për t'u riparuar në servis.

2. Autorizimi për riparimin e mjeteve në servis jepet vetëm nga personi i autorizuar i shoqërisë së sigurimit.

3. Riparimi i mjetit të dëmtuar kryhet vetëm në servise të regjistruara pranë organeve tatimore me të cilët është lidhur më parë aktmarrëveshja përkatëse nga shoqëria e sigurimit.

4. Ekspertimi i mjetit të dëmtuar bëhet i përbashkët ndërmjet ekspertit të shoqërisë së sigurimit, përfaqësuesit të servisit dhe palës së tretë/të dëmtuarit dhe firmoset prej tyre.

5. Secila palë ka të drejtë të pajiset me një kopje të aktekspertimit të dëmit.

6. Riparimi konsiderohet i përfunduar kur pala e tretë/i siguruari nënshkruan formularin "Deklarimi i pranimit të riparimit të mjetit".

7. Dorëzimi i mjetit nga ana teknike, para dhe pas riparimit, bëhet me procesverbal në prani të përfaqësuesit të servisit, palës së tretë/të siguruarit.

8. Dëmshpërblimi i paguhet palës së tretë/të siguruarit, përfaqësuesit ligjor të saj ose servisit të autorizuar, kur kjo bëhet me kërkese apo me miratim me shkrim të palës së tretë/të siguruarit.

9. Lëshimi i faturës nga servisi bëhet pas pranimit, pa pretendime të mjetit të riparuar nga pala e tretë/i siguruari.

KREU VIII

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PASAGJERËVE NË TRANSPORTIN PUBLIK

Neni 35

E drejta për dëmshpërblim

Pasagjeri i përfshirë në një aksident ose trashëgimtarët e tij, në rastin kur pasagjeri vdes, ka të drejtë sipas kushteve të kontratës së sigurimit të kërkojë që shoqëria e sigurimit, me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit, të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë drejtpërdrejtë tek ai.

Dëmshpërblimi për humbjet e pësuara në rast aksidenti përfshin:

1. Dëm pasuror ndaj personit me pasojë vdekje.
2. Dëm pasuror ndaj personit për paaftësie të përhershme për punë.
3. Dëm pasuror ndaj personit për paaftësi të përkohshme për punë dhe trajtimet mjekësore.

Neni 36

Kërkesa për dëmshpërblim

1. Në rast të ndodhjes së aksidentit, i siguruari/pasagjeri i dëmtuar ose trashëgimtarët e tij, në rastin kur pasagjeri vdes, është i detyruar të njoftojë shoqërinë e sigurimit, me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit.

2. Njoftimi bëhet brenda 10 ditëve nga data e ndodhjes së aksidentit ose nga momenti që pala e dëmtuar ka pasur mundësi të dërgojë njoftimin.

3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike dhe duhet të tregojë vendin, ditën, orën, shkakun e aksidentit, mjetin e transportit, si dhe itinerarin e udhëtimit.

4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

5. Nëse pronari i një mjeti motorik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve, sipas dispozitave të ligjit nr. 32/2021 dhe aksidenti ka ndodhur, pasagjeri ose personi përfitues ka të drejtë të kërkojë pagesën e shumës së siguruar nga Fondi i Kompensimit.

Neni 37

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 90 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

2. Për qëllim të pikës 1, të këtij neni, data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues.

Neni 38

Dokumentacioni i dosjes së dëmit

1. Praktika e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik përmban:

a) njoftimi/kërkesa e të siguruarit/pasagjerit të dëmtuar ose përfituesit të tij, në rastin kur pasagjeri vdes, për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 36 "Kërkesa për dëmshpërblim" të kësaj rregulloreje;

b) certifikata mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore të pasagjerit të dëmtuar;

c) raportin mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë, i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë";

d) radiografi/skaner/rezonancë magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente;

e) dokumenti i identifikimi të personit;

f) bileta e udhëtimit/karta ose ndonjë dokument tjetër në origjinal që provon se pala e aksidentuar ka qenë pasagjer;

g) konfirmim me shkrim nga i siguruari se, personi i dëmtuar ka qenë pasagjer i tij. I siguruari është i detyruar të vërtetojë se i aksidentuari ka qenë pasagjer duke udhëtuar me mjetin e tij, pavarësisht nga fakti nëse personi i dëmtuar ishte pajisur me biletë apo udhëtonte pa pagesë për shkak të një statusi ligjor;

h) konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

i) raport i policisë rrugore për ngjarjen, nëse ka;

j) certifikata e vdekjes (në rast të vdekjes së pasagjerit);

k) skeda e vdekjes;

l) akti/vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

m) deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës se dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveç sa është parashikuar pikën 1 të këtij neni, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 39

Përllogaritja e dëmit me pasojë vdekje

Në rastin e vdekjes së pasagjerit si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit llogarit vlerën e dëmshpërblimit sipas nenit 15, të kësaj rregulloreje brenda kufirit të përcaktuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, germa a), të Ligjit nr. 32/2021.

Neni 40

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme në punë

Në rastin e paaftësisë së përhershme të pasagjerit si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit llogarit vlerën e dëmshpërblimit sipas nenit 14, të kësaj rregulloreje brenda kufirit të përcaktuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, germa "b", të ligjit nr. 32/2021.

Neni 41

Përllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përkohshme në punë dhe trajtimet mjekësore

Në rastin e paaftësisë së përhershme të pasagjerit si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit llogarit vlerën e dëmshpërblimit sipas nenit 16, të kësaj rregulloreje brenda kufirit të përcaktuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, germa "c", të ligjit nr. 32/2021.

KREU IX

BSHS DHE SHOQËRITË E SIGURIMIT SI ENT KOMPENSUES

Neni 42

Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga Fondi i Kompensimit

1. Praktikat e dëmeve, objekt i fondit të kompensimit, sipas parashikimeve të nenit 41, të ligjit nr. 32/2021, trajtohen dhe paguhen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

2. Për ndjekjen e procedurave, trajtimin e dëmeve, kryerjen e pagesave dhe ndjekjen e rimbursimeve nga fondi i kompensimit, BSHS-ja mund të delegojë dhe autorizojë njërin prej anëtarëve të saj.

3. Procedura e trajtimit dhe llogaritjes së dëmshpërblimit sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

4. Praktikat e dëmeve objekt i fondit të kompensimit raportohen në regjistrin elektronik të dëmeve që administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, sipas procedurave të raportimit të miratuara nga Autoriteti.

Neni 43

Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit si ent kompensues

1. Praktikat e dëmeve trajtohen dhe paguhen nga Shoqëritë e Sigurimit, si sigurues i drejtpërdrejtë, sipas parashikimeve të nenit 43, të ligjit nr. 32/2021.

2. Procedura e trajtimit dhe llogaritjes së dëmshpërblimit sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

3. Praktikat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit raportohen në regjistrin elektronik të dëmeve që administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, sipas procedurave të raportimit të miratuara nga Autoriteti.

Neni 44

Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim nga përdorimi i mjetit motorik me karton jeshil

1. BSHS-ja miraton dhe paguan të gjitha kërkesat për dëmshpërblim, që rrjedhin nga aksidentet e ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë të shkaktuara nga automjete me targa të huaja të pajisura me karton jeshil, sipas nenit 28, të Ligjit 32/2021.

2. BSHS-ja mund të delegojë shqyrtimin dhe pagesën e një dëmi të tillë anëtarëve të saj ose një korrespondenti të emëruar nga BSHS, të cilët janë të detyruar ta trajtojnë dëmin, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë nga përdorimi i mjeteve motorike.

KREU X

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARËVE TË AVIONIT PËR DËMIN SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA

Neni 45

E drejta për dëmshpërblim

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen:

1. Çdo dëm shkaktuar palëve të treta, me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore dhe dëmtim apo shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;

2. Dëme shkaktuar pasagjerëve me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore gjatë përdorimit të avionëve;

3. Dëmtime ose humbje të sendeve personale të pasagjerëve që janë të vendosura në kabinën e avionit;

4. Dëmtime ose humbje të mallrave në transport (*cargo*) dhe të bagazheve që kanë kaluar procesin e regjistrimit.

Neni 46
Kërkesa për dëmshpërblim

1. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë siguruesin përgjegjës së pronarit të avionit.

2. Pala e dëmtuar, sipas Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, humbet të drejtat e tij për dëmshpërblim nëse ai nuk paraqet kërkesë brenda një periudhe prej 3 vjetësh, nga momenti kur ai vihet në dijeni për dëmet dhe për personin përgjegjës të aksidentit.

3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike.

4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

5. Nëse pala e dëmtuar paraqet dokumente false apo mashtron lidhur me ngjarjen e ndodhur, shoqëria e sigurimit ka të drejtë të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim.

Neni 47
Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 90 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Neni 48
Dokumentacioni i dosjes së dëmit

1. Praktika e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëmin shkaktuar palëve të treta përmban:

a) njoftimin/kërkesën e të siguruarit/palës se dëmtuar ose përfituesit të tij, në rastin kur i dëmtuari vdes, për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 45 të kësaj rregulloreje;

b) raport të plotë të Autoritetit Kompetent të trafikut ajror për ngjarjen e ndodhur duke dhënë të gjitha hollësitë e nevojshme për ndodhjen e një ngjarje të tillë, si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton ngjarjen e ndodhur;

c) raporti për ngjarjen e ndodhur duhet të përmbajë njoftim për çdo ndjekje penale që ka lidhje me ngjarjen;

d) konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

e) dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose humbjen e sendeve personale të pasagjereve që janë të vendosur në kabinën e avionit si dhe të mallrave në transport (*cargo*) dhe bagazheve;

f) Dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;

g) bileta e udhëtimit/karta ose ndonjë dokument tjetër në origjinal që provon se pala e dëmtuar ka qenë pasagjer;

h) certifikata mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore personit të dëmtuar;

i) raport mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë";

j) radiografi/skaner/rezonancë magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente;

k) dokumenti i identifikimi të personit të dëmtuar;

l) certifikata e vdekjes (në rast të vdekjes së personit);

m) skeda e vdekjes;

n) akti/vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

o) deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 49

Përllogaritja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëmin shkaktuar palëve të treta

1. Përllogaritja e dëmit me pasojë vdekje, dëmtime trupore dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore, do të bëhet sipas parashikimeve të kreut III të kësaj rregulloreje.

2. Përllogaritja e dëmit me pasojë dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë do të bëhet me vlerën e zëvendësimit të pasurisë së dëmtuar ose të shkatërruar, por jo më shumë se limiti i përcaktuar në nenin 53, të ligjit nr. 32/2021.

3. Përllogaritja e dëmtimeve ose humbjeve të sendeve personale të pasagjerëve të vendosura në kabinën e avionit do të jete në masën 1000 SDR.

4. Përllogaritja e dëmtimeve ose humbjeve të mallrave në transport dhe të bagazheve të pranuara (*check-in*) do të jetë 17 SDR për kg, sipas dokumentacionit shoqërues të mallit.

5. Masa e dëmshpërblimit e përllogaritur sipas këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se shuma e sigurimit e përcaktuar në nenin 53, të ligjit nr. 32/2021.

KREU XI

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARËVE TË MJETEVE LUNDRUESE PËR DËMIN E SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA

Neni 50

E drejta për dëmshpërblim

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen çdo dëm ndaj pronës dhe personit, të shkaktuara ndaj palëve të treta, që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve të vogla lundruese për dëmin e shkaktuar palëve të treta.

Neni 51

Kërkesa për dëmshpërblim

1. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë siguruesin përgjegjës të pronarit të mjetit lundrues.

2. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike.

3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

4. Nëse pala e dëmtuar paraqet dokumente të rreme apo mashtron lidhur me ngjarjen e ndodhur, shoqëria ka të drejtë të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim.

Neni 52

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim për dëmet ndaj pronës dhe brenda 90 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit për dëmet ndaj personit.

Neni 53

Dokumentacioni i dosjes së demit

1. Praktika e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve lundruese për dëmin shkaktuar palëve të treta përmban:

a) njoftimin/kërkesën e të siguruarit/palës së dëmtuar ose përfituesit të tij, (në rastin kur i dëmtuari vdes), për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 51 të kësaj rregulloreje;

b) dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit lundrues në regjistrin e mjeteve lundruese;

c) raport të plotë të Autoritetit Portual/Organit kompetent përkatës për ngjarjen e ndodhur, duke dhënë të gjitha hollësitë e nevojshme për ndodhjen e saj si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton ngjarjen e ndodhur;

d) raporti për ngjarjen e ndodhur duhet të përmbajë njoftim për çdo ndjekje penale që ka lidhje me ngjarjen;

e) konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

f) dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë;

g) certifikata mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore të personit të dëmtuar;

h) raport mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë";

i) radiografi/skaner/rezonance magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali, si dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente;

j) dokumenti i identifikimi të personit të dëmtuar;

k) certifikata e vdekjes (në rast të vdekjes së personit);

l) skeda e vdekjes;

m) akti/vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

n) deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e tij.

Neni 54

Përllogaritja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve lundruese për dëmin shkaktuar palëve të treta

1. Përllogaritja e dëmit me pasojë vdekje, dëmtime trupore dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore, do të bëhet sipas parashikimeve të kreut III të kësaj rregulloreje.

2. Përllogaritja e dëmit me pasojë dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë do të bëhet me vlerën e zëvendësimit të pasurisë së dëmtuar ose të shkatërruar.

3. Masa e dëmshpërblimit e përllogaritur sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e sigurimit e përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 32/2021.

KREU XII

Neni 55
Kontabilizimi i dëmeve

1. Pagesa e dëmshpërblimit kryhet nga shoqëria e sigurimit përgjegjëse, BSHS-ja ose nga siguruesi i drejtpërdrejtë sipas parashikimeve të nenit 43, të ligjit nr. 32/2021.

2. Shpenzimet për dëme nga shoqëria e sigurimit përgjegjëse klasifikohen të ndara në "shpenzime për dëme të paguara" dhe "shpenzime për trajtim dëmesh".

3. Në zërin "Shpenzime për dëme të paguara", regjistrohet vlera e dëmshpërblimit që përfiton personi i dëmtuar/familjarët e tij/palë të treta në rastin e riparimeve të mjeteve të dëmtuara në servis ose klinikave mjekësore, i llogaritur sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

4. Shpenzimet për dëme të paguara klasifikohen të detajuara sipas llojit të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit si dhe sipas çdo portofoli sigurimi.

5. Në zërin "Shpenzime për trajtim dëmesh", regjistrohen shpenzimet e tjera që lidhen drejtpërdrejtë me trajtimin e dëmeve. Këtu përfshihen:

a) shpenzime për vlerësuesit e dëmeve;

b) konsulenca për trajtim dëmesh;

c) ekspertiza;

d) investigime;

e) shpenzime gjyqësore dhe noteriale;

f) shpenzime për parandalim dëmesh;

g) shpenzime për rimorkim, parkim;

h) kosto të marrjes me qira në rastin kur shoqëria e sigurimit vë në dispozicion të palës së dëmtuar mjet me qira deri në riparimin e mjetit të tij;

i) të tjera shpenzime që lidhen drejtpërdrejtë me trajtim dëmesh.

6. Në rastin e pagesës së dëmshpërblimit nga siguruesi i drejtpërdrejt, ky i fundit i pasqyron shpenzimet e mësipërme sipas standardeve të kontabilitetit, ndërsa shoqëria e sigurimit përgjegjëse i pasqyron ato menjëherë me plotësimin e dosjes së demit.

7. Regjistrimet e mësipërme duhet të pasqyrohen të rregullta dhe të sinqerta, në përputhje me standardet e kontabilitetit.

KREU XIII
Neni 56
Dispozita kalimtare

Kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi ligjit nr. 32/2021 do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi në datën e aksidentit.

Neni 57
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tabela nr. 1. Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar.

Mosha	Koe M	Koe F	Mosha	Koe M	Koe F
12	25.55	26.15	47	18.77	20.01
13	25.43	26.05	48	18.47	19.72
14	25.31	25.95	49	18.15	19.42
15	25.19	25.84	50	17.83	19.12
16	25.06	25.74	51	17.50	18.81
17	23.96	24.65	52	17.16	18.48
18	24.80	25.51	53	16.82	18.15
19	24.67	25.40	54	16.46	17.81
20	24.53	25.27	55	16.11	17.46
21	24.38	25.15	56	15.74	17.10
22	24.24	25.02	57	15.37	16.73
23	24.08	24.88	58	14.99	16.35
24	23.93	24.75	59	14.60	15.96
25	23.77	24.60	60	14.20	15.56
26	23.60	24.46	61	13.80	15.15
27	23.43	24.30	62	13.40	14.73
28	23.25	24.14	63	12.98	14.30
29	23.07	23.98	64	12.56	13.86
30	22.88	23.81	65	12.14	13.42
31	22.69	23.64	66	11.72	12.97
32	22.49	23.46	67	11.29	12.51
33	22.29	23.27	68	10.87	12.05
34	22.08	23.08	69	10.44	11.59
35	21.87	22.88	70	10.02	11.12
36	21.65	22.68	71	9.60	10.65
37	21.43	22.47	72	9.18	10.19
38	21.20	22.26	73	8.76	9.72
39	20.96	22.03	74	8.34	9.26
40	20.72	21.81	75	7.93	8.80
41	20.46	21.57	76	7.53	8.35
42	20.20	21.33	77	7.13	7.90
43	19.93	21.08	78	6.74	7.46
44	19.65	20.82	79	6.37	7.04
45	19.37	20.56	80	6.0	6.6
46	19.07	20.29			

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1. Tabela nr. 2. "Shkalla e humbjes së aftësisë së përhershme në punë" është e mbështetur kryesisht në *"**European physical and mental disability rating scale for medical purposes**",* të Bashkimit Evropian, si dhe në tabelat analoge të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor (Kroaci, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni). Në këtë tabelë, janë listuar pasojat *(sekuelat)* e përhershme pasojë e dëmtimeve traumatike nga mjetet motorike dhe në shumicën e rasteve janë të shprehura në përqindje fikse si p.sh. 15%, 40% etj.

Tabela është ndërtuar në përshtatje me topografinë regjionale të sistemeve të organeve të trupit njerëzor është e ndarë në gjashtë pjesë, secila e titulluar me emrin "Artikull", me numra nga 1 deri në 6. Çdo artikull ndahet në pika dhe nënpika si p.sh. art. 1, pika 1.1, nënpika 1.1.1 e kështu me radhë për secilën pasojë të çdo dëmtimi traumatik.

Vlerësimi mjekësor, në dëmtimet serioze duhet të kryhet në një kohë kur gjendja shëndetësore e të dëmtuarit të ketë arritur një përmirësim mjekësor maksimal, pra rikuperimi të jetë arritur në

masën më të mirë të mundshme dhe gjendja invalidizuese e pacientit konsiderohet e palëvizshme. Në këtë kontekst, koeficienti i paaftësisë nuk mund të përcaktohet të paktën para 6 muajve nga data e dëmtimit, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe, duke bërë parashikime sa më të sakta për ecurinë e gjendjes shëndetësore dhe përmirësimin e tij maksimal të mundshme; konkluzione për ardhmërinë e të dëmtuarit në bashkëpunim me specialistët e fushave të ndryshme mjekësore.

Vlerësimi mjekësor në përcaktimin e pasojave *(residuave)* shëndetësore duhet të përshtatë rregullat e mëposhtme:

- të identifikojë të gjitha dëmtimet traumatike, në momentin e traumës sipas përshkrimit të mjekëve të qendrave shëndetësore e spitalore;

- të përcaktoje diagnozën dhe të analizojë ashpërsinë e dëmtimeve dhe pasojat që ato lenë ose do të lënë në jetën e përditshme shoqërore profesionale të të dëmtuarit edhe kur nuk kanë mbaruar procedurat mjekësore të shërimit e rehabilitimit;

- të vlerësojë në përqindje shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të personit të dëmtuar;

- të parashikojë në rastet kur i dëmtuari është në vazhdimësi të procedurave mjekësore paaftësinë pas përfundimit të tyre.

Vlerësimi për përcaktimin e pasojave shëndetësore duhet të bazohet:

1. Në shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumenteve mjekësore që duhen të jenë pjesë e "Dosjes së dëmit":

a) *kartelat klinike t*ë *trajtimit spitalor të të dëmtuarit* (fotokopje e vulosur dhe firmosur nga përgjegjësi i zyrës së statistikës së institucionit);

b) *kartela mjekësore personale e shërbimit ambulator të lagjes ku banon i dëmtuari* (fotokopje e vulosur dhe firmosur nga përgjegjësi i zyrës së statistikës së institucionit);

c) *epikriza zyrtare të ndryshme apo konsulta mjekësore me firmën dhe vulën personale të specialistit përkatës.*

d) raporte paaftësie modular tip A dhe B, ose nga komisionet mediko-legale apo nga KMCAP-i;

e) *ro-grafi, skaner, rezonancë magnetike dhe çdo dokument tjetër të lëshuara nga institucionet mjekësore, që mund t'i disponojë i dëmtuari*;

f) *aktekspertimi* zyrtar i mjekësisë ligjore;

g) të dhënat e ekzaminimeve plotësuese, ose konsultave specialistike, krahas pasqyrimit në akt duhet t'i bashkëlidhet akti i vlerësimit.

2. PARIMET METODOLOGJIKE TË PËRCAKTIMIT TË KOEFICIENTIT TË PAAFTËSISË

- Caktimi i përqindjeve bëhet në mënyrë të përshkallëzuar nga 0 deri 100% (totali nuk mund ta tejkalojë 100%-in).

- Në raste të veçanta, kur pasojat e dëmtimeve trupore ndërthuren me pasojat nga një ngjarje të vjetër aksidentale e të dëmtuarit, vlerësimi duhet të bëhet duke zbritur përqindjen e mëhershme të zvogëlimit të aktivitetit jetësor.

- Te pasojat e dëmtimeve të shumëfishta që mund të jenë njëkohësisht të pranishme në regjione të ndryshme të trupit (politraumat) si në kokë, kraharor apo gjymtyrë, përqindja e përgjithshme llogaritet duke filluar nga pasoja që ka përqindjen më të lartë, dhe më pas përqindjet vijuese caktohen duke u bazuar në rregullin në formulën e përcaktuar në këtë kapitull.

- Përqindjet e dëmtimit të gishtave mblidhen matematikisht.

- Kur vlera del me presje dhjetore shifra rrumbullakoset me numërorin më lart (p.sh., 10.1 rrumbullakoset 11).

3. METODA PËR LLOGARITJEN E PAAFTËSISË SË PËRHERSHME

Vlerësimi në përqindje do të bëhet sipas artikujve të paraqitur në tabelën 2.

Në rastet e disa dëmtimeve trupore do të bëhet përllogaritja e humbjes të aftësisë për punë me metodën gjeometrike, duke bërë renditjen nga përqindja më e lartë deri te më e ulëta, sipas formulës më poshtë:

Formula: 1+1/2+1/4+1/8 etj.

1 Është dëmtimi i parë i plotë që korrespondon me përqindjen më të lartë

½ Është dëmtimi i dytë që korrespondon me përqindjen e dytë më të lartë (nëse ka dëme të tjera)

¼ Është dëmtimi i tretë që korrespondon me përqindjen e tretë më të lartë (nëse ka dëme të tjera)

1/8 Është dëmtimi i katërt që korrespondon me përqindjen e katërt më të lartë (nëse ka dëme të tjera)

Nëse ka dëmtime të tjera vazhdohet formula sipas progresionit në zbritje.

Tabela nr. 2. Shkalla e humbjes së aftësisë për punë

Renditja	Përmbajtja	Niveli i paaftësisë në %
	Art.1 Pasojat e dëmtimeve traumatike të kokës	
Pika 1.1	**Sekuelat në SNQ (kranio-cerebrale)**	
1.1.1	Lëndime të rënda morfologjike të trurit:	
	a) Gjendje klinike vegjetative (dekortikimi trunor)	**100%**
	b) Tetraplegjia dhe triplegjia me humbje të plotë të veprimeve të pavarura për të kryer aktivitete të nevojave jetësore (varësi e plotë nga të tjerët)	**90%**
1.1.2	Lëndime të rënda morfologjike të trurit me pasojë të deficiteve motore:	
	a) hemiplegjia komplete me afazi	**90%**
	b) hemiplegji komplete pa afazi	**75%**
	c) paraplegji	**70%**
	d) monoplegji	**40%**
Shënim. Për tetraparezën, triparezën, hemiparezën, paraparezën dhe monoparezën caktohet për analogji deri në 2/3 e përqindjes të paaftësisë të caktuar për atë lloje paralize. Vlerësimi të jetë i mbështetur nga specialisti i fushës përkatëse.		
1.1.3	Epilepsitë me humbje të vetëdijes, që nuk mund të kontrollohet nga terapia, me përkeqësim fizik dhe mendor, me atakë disa herë në javë	**65%**
1.1.4	Epilepsitë me humbje të vetëdijes, që kontrollohen me vështirësi nga terapia, me atakë disa herë në muaj	**40%**
1.1.5	Epilepsitë me humbje të vetëdijes, që kontrollohen mirë nga terapi	**20%**
1.1.6	Epilepsitë pa humbje të vetëdijes, me atakë të thjeshta fokale, të diagnostikuara dhe konfirmuara sipas llojit të atakut, shpeshtësisë dhe me efekte anësorë gjatë mjekimit	**15%**
1.1.7	Lëndim morfologjik i trurit me funksion të dëmtuar cerebral (marramendje, çrregullim të baraspeshës gjatë qëndrimit në këmbë dhe në ecje)	**30%**
1.1.8	Gjendje pas hematomë e operuar intracerebrale ose subdurale, si dhe kontuzioni cerebral, me çrregullime të vazhdueshme të funksioneve të sistemit nervor vegjetativ	**30%**
1.1.9	Gjendje pas trepanacionit të kafkës, gjendje pas hematomes epidurale të operuar, gjendje pas frakturës së bazës ose të kubesë së kafkës së paoperuar	**10%**
1.1.10	Sindroma parkinsoniane	
	a) e formës së lehtë	**30%**
	b) e formës së mesme	**50%**
	c) e formës së rëndë	**70%**
1.1.11	Sindroma pseudobulbare	**60%**
1.1.12	Sindroma cerebelare:	
	a) unilaterale	**20%**
	b) bilaterale	**40%**
1.1.13	Meningjiti posttraumatik me kriza të dhimbshme, radikuloalgji, çrregullime të karakterit	**20%**

1.1.14	Sindroma pas tronditjes së trurit (postcommotio cerberi) të konfirmuar në vijimësi me EEG, ekzaminime otovestibulare dhe oftamologjike	**10%**
